

Tasim  
Gjokutaj



BISEDE  
ME  
MBESEN

poema



81H-98-1  
BPL.

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

Rezervuar  
GJENIOS GJRTI

Tasim  
Gjokutaj

Bisedë  
me  
mbesën



POEMA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

Bisedë  
me  
mbesën

1.

Unë s'kam qenë gjithnjë gjyshe,  
flokëbardhë me syze në sy,  
moj mbesëz, kam qenë dhe ndryshe,  
e vogël, e vogël sa ti.

Kam pasur ca shoqe në fshat,  
si shoqet e tua, të mira,  
gëzime dhe bukë kishim pak,  
po kishim një mal me dëshira.

Dhe kukullat i donim, i donim,  
po s'patëm një kukull, të shkretën,  
me lecka e pecka sajonim  
ca kukulla të varfra si veten...

Kam pasur një shoqe, moj Edë,  
Burbuqen, të bukur si nuri,  
me sytë të kaltër si deti,  
me flokët të artë si gruri.



Me çapin të lehtë, thëllëzë,  
oh, lëre se ç'vajzë që ishte,  
s'arriti ditëzeza të bëhej  
as nuse, as nënë, as gjyshe.

Si iku? As unë s'e kuptova,  
dy ditë në lojë pat' munguar;  
ndaj shkova me vrap e kërkova,  
më thanë: «Te halla ka shkuar!»

Më thanë: «Te halla ka shkuar,  
në fshatin pesë male kaptuar...»  
E prita në lëmë te ledhi  
një ditë, dy ditë... po s'erdhë.

Malli më piku, letra, nuk bënim,  
se shkronjat, moj mbesë, s'i dinim,  
ndaj dilja çdo mbrëmje te lëmi  
të pyesja gjith' zogjtë që vinin.

Ata s'më tregonin asgjë  
Ç'u bë ajo vajzë, ç'u bë?

2.

Kur oxhakët villnin tym  
mbi kasolle, si çibukë,  
dhe dëbora me thëllim  
mbuloi fshatin pup e pup!

erdh' një lajm i zi si nata,  
që të gjithë i mallëngjeu:  
«Burbuqen me flokë të arta,  
thonë... lumi e rrëmbeu».

Kur e thanë atë emër,  
qysh u mbajta, nuk e di,  
si një thikë e fortë në zemër  
më goditi lajmi i zi.

Mora rrugën për në lumë,  
lumi rridhte tatëpjetë,  
thihhte borë e nxirrte shkumë  
dhe nxitonte për në det...

«Ndal, o lumë, ndal, moj borë!  
Ndal, pa ndal dhe ti, moj erë!  
Shoqen time, kush e mbyti?  
Hë pra, flisni, po ju them!»

Lumi rend me vrap si kalë,  
bora bie pa pushim,  
ndërsa era nëpër mal  
ulurin e ulurin...

3. Një djalë nga fshati  
lajm tjetër përhapi:  
«Vajzën e filanit  
nuk e mbyti lumi,  
e mbyti... Kanuni!»

Një djalë nga fshati  
lajm tjetër përhapi:  
«Vajzën e filanit  
nuk e mbyti lumi,  
e mbyti... Kanuni!»

Kanuni s'qe lumë,  
as pushkë, as litar,  
Kanuni qe libër  
i ngopur me fjalë.

Ti, Eda, ke sot  
plot libra të bukura  
me yje, me zogj,  
me trena, me flutura.

Si librat e tua  
Kanuni nuk ishte,  
ai brenda kishte  
ligje të çuditshme:



«Gruaja të heshtë,  
gjuhën ta shtrëngojë,  
nën thundrën e burrit  
gjithë jetën të rrojë!

Të punojë më shumë  
sesa një gomar,  
se ajo ha bukë,  
gomari ha bar!

Të shitet, të blihet  
si lopa në treg,  
të fejohet foshnjë,  
që kur është në djep!

Eda, e hutuar,  
e pyeti gjyshen:  
— Gjyshe, kush i nxori  
gjithë këto ligje?

U mundua gjyshja  
dhe tha zemërvrarë:  
— Nëpër fshatrat tonë  
kishte bajraktarë...

...Që t'u rritej froni,  
që t'u shtohej prona,  
mbollën errësirën  
përmbi malet tonë,  
se në errësirë  
ujku çan më mirë.

Armiqtë dhe feja,  
me thika, me kryqe,  
pinin gjak nga ne,  
pastaj villnin ligje.

Në shekuj kaluan  
ligjet gojë më gojë,  
vonë dikush i mblodhi,  
i shkroi me bojë.

Me bojë të zezë,  
shkruar nëpër fleta,  
këto ligje ngjanin  
tamam si akrepa.

Akrepat me helm,  
me bishtin e gjatë,  
helmin më të hidhur  
e kishin për gratë.

«Gruaja të heshtë,  
gjuhën ta shtrëngojë,  
nën thundrën e burrit  
gjithë jetën të rrojë!

Të punojë më shumë  
sesa një gomar,  
se ajo ha bukë,  
gomari ha bar!

Të shitet, të blihet  
si lopa në treg,  
të fejohet foshnjë,  
që kur është në djep!»

Ligje si këto  
e të tjera shumë,  
shkruheshin në librin  
që quhej Kanun...

4.

Nxitur nga Kanuni,  
një plakut iu ték  
që një nuse tjetër  
ta blinte me lek.

Dikush i kish thënë  
se larg... në një fshat  
është një vajzë si hënë,  
me flokët e artë.

Është pak e parritur,  
e quajnë Burbuqe...  
Plaku nisi mblesër  
ta kërkojë pér... nuse.

Mblesët, si nepërkat,  
ditë e natë s'u ndalën,  
një ec e një eja,  
gjersa morën fjalën.

«Vajza është e vogël,  
do prisni dy vjet!»  
«S'ka gjë, do ta marrë  
ta ketë për hyzmet!»

Baba përtyp dhembje,  
nëna përtyp lotë...  
«Kjo martesë do të bëhet,  
Kanuni e thotë!»

5.

Dhe një natë me hënë,  
me yje të rralla,  
e nisën Burbuqen  
gjoja për te halla.

Plaku shkon përpara,  
Burbuqja në mes,  
prapa katër krushq,  
prapa katër mblesë.  
Vellon ku e ka?  
Vello... nata e zëzë!

Hëna, sipër reve,  
sikur pikon lot,  
plaku thot' me vete:  
«Lekët s'vanë kot.

Paskam blerë një nuse,  
të bukur si ylli...»  
Plaku lëpin jargët,  
si jargë kërmilli.

E dëgjoi Burbuqja,  
iu bënë faqet prush,  
tani e kuptoi  
të gjithë atë kurth.

Me kë të fjaloset?  
Sytë i hedh përreth,

natë e zezë u nxi,  
Burbuqja u zverdh.  
Lumi ndënë urë  
grindet e bën zhurmë...

Ajo fluturoi  
e u hodh mbi dallgë,  
lumi e mbështolli  
me vello të bardhë.

Kështu shkoi Burbuqja,  
Burbuqja që s'çeli,  
dhe në mendjen time  
si legjendë nigeli...

**6.**

Rrodhën vitet, rrodhhi gjaku si ujë lumi,  
vajzat më nuk mbyten, se mbytëm Kanunin.

Kemi sot një libër me kapak të kuq, nuk i thonë Kanun i thonë **KUSHTETUTË!**

Neni dyzet e një  
për jetë do të ndrisë!  
Ç'diell që na solle,  
moj kohë e Partisë!

7.

Unë s'kam qenë gjithnjë gjyshe,  
flokëbardhë, me syze në sy, ...  
kam qenë, moj mbesëz, dhe ndryshe,  
e vogël, e vogël sa ti.

Dhe ti e vogël s'do rrish,  
do rritesht, moj Edë, moj flutur,  
do bëhesh një mami e mirë,  
do bëhesh një gjyshe e lumtur!

**Il  
Udha  
e  
kurbetit**

---

II  
Udbud  
e  
kupeti

## Kënga e parë

### MUZEU I DHEMBJES

Historia ka rrënëjë

kudo në Atdhe,

prandaj dhe kanë mbirë

me qindëra muze.

Midis gjithë muzeve,

si ushtarët në rrështh,

qëndron dhë në Dröpull

një muze i thjeshtë

i lotit, i dertit,

i plagës së madhe:

«Muzeu i kurbetit».

Në mure ca foto  
dalë qëmoti,  
zverdhur nga koha,  
kripur nga loti.

I kanë ruajtur  
si perlat deti  
në sënduqet e pajës,  
nën jastëkët e djepit.

Çdo gjë në muze  
ka erë kurbeti,  
ca zarfa, ca letra,  
ca këngë që të ngjethin:

«O kurbet i shkretë, na le pa shtëpi,  
me zemër zhuritur, o për Shqipëri.  
Mbetën nënrat tona gjith' jetën në zi,  
mbetën motrat tona me lötë mbi faqe,  
mbetën gratë e gjora pa bukë në magje...»

\* \* \*

Këtu pranë muzeut,  
në shtëpinë përballë,  
rron një kurbetlli,  
një muze i gjallë.

Vitet, rrudhat, thinjat,  
eh, sa gjëra thonë...  
Eni ta pyesim,  
eni ta dëgjojmë!

## Kënga e dytë

### TREGIMI I NJË KURBETLLIU

Zunë yjet po rrallojnë,  
zunë kurbetllinjtë e shkojnë.

Populli

Jam lindur tek ata gurë,  
ja tek ai man,  
hallet shpejt më bënë burrë,  
s'e njoha babanë.

Ai mal ka qenë atje  
tek e shihni ju,  
edhe fusha këtu qe,  
po nuk ish kështu.



Mali ish pronë e agait,  
fusha qe çiflik,  
rridhte djersë e fukarait,  
misër asnje çikë.

U plak nëna para kohe  
nga sëmundje e rëndë,  
për ilaçe merrnim borxhe,  
shërohu, moj nënë!

Borxh për bukë, borxh për ilaçe,  
borxhe, vetëm borxhe...  
Dhe gëzimet që na lindnin  
vyshkeshin qysh gonxhe.

U martova. Pas një viti  
nusja lindi djalë,  
në shtëpi një rrëze ndriti.  
«Pastë këmbën e mbarë!»

Po urimi s'qenkësh gjë,  
jeta qe farmak...  
I thashë zemrës: «Plas, moj zemër,  
se do ikim larg!»

Cërr... ia bëri zemra e shkretë  
dhe trupi m'u mpi...  
«Yt at' në kurbet u tret,  
do tretesh dhe ti...»

«S'kam ç'të bëj, punoj gjithë vitin,  
s'hedh gjë në hambar,  
borxhet më shtrëngojnë fytin,  
borxhet duhen larë.»

E vendosa. Qe vështirë  
që t'ia thosha zemrës,  
po vështirë e më vështirë  
si t'ia thosha nënës.

Plasi kuja në shtëpi,  
nëna, nusja, djali...  
...O kurbet, kurbet i zi,  
pse s'të dogji zjarri!

N'errësirë, për çdo natë.  
nëna flit me vete:  
«Në kurbet u tret yt atë,  
rri, o bir, ku vete!»

Sýtë e nuses, pus me lotë,  
thoshin me trishtim:  
«Djali do të bëhet shok,  
mos e lër' jetim!»

Edhë magjja në një qoshe,  
krejt e boshatisur,  
seç më dukej sikur thoshte:  
«Akoma s'je nisur?!»

\* \* \*

Bëmë një darkë sipas zakonit,  
darkën e kurbetit,  
miqtë nisën të këndonin  
këngë që të ngjethnin:

- Ku je nisur e do vec,  
djalë, o djalë i ri?
- Jam nisur për në kurbet,  
nuse, moj Sofi!
- Merrmë dhe mua me vete.
- Udhë është e gjatë e trete!

## Kënga e tretë

### UDHA E KURBETIT

O udha për në kurbet,  
dyzet ditë e dyzet net...

Dallgët shkojnë e dallgët vijnë  
me jehonë,  
nuk këndojnë, po ulérijnë-  
fatin tonë.  
Dhe direku i vaporit  
kërkëllin  
dhe ai për fatin tonë  
ulerin.

Dyzet ditë e dyzet net,  
vaj medet,  
s'shohim tokë, po vetëm det,  
një fjalë shqip, asnjë s'na flet,  
sa i hidhur je, kurbet,  
vaj medet!



O ju zogj që fluturoni,  
lum si ju,  
te foleja mund të shkoni,  
mund të shkoni kur të doni,  
lum si ju!

### LALLA TIRANË

Neve na ndau vapori,  
mjerë si ne,

Nuk e dimë, kur do vijmë  
prapë atje,  
u shpërndamë si jetimë,  
Mëmëdhe!

Prapë atje gjithë

Prapë atje gjithë  
shpërndamë si jetimë  
Mëmëdhe!

Prapë atje gjithë  
shpërndamë si jetimë  
Mëmëdhe!

## Kënga e katërt

### NE DHE TE HUAJ

...Disa mendojnë  
atje në fshat  
se ne po mbledhim  
lekë me... lopatë...

Mëngjes me mjegull,  
mëngjes i huaj...  
...Neve na nxorën  
në treg si kuaj.

Disa xhambazë,  
disa pronarë,  
na panë muskujt,  
dhëmbët na panë.

Pronarët heshtnin,  
xhambazët flitnin,  
bejlerëve tanë  
sa shumë u ngjitnin.

(S'u thoshin «bej»,  
u thoshin «sër»,  
po një turi  
kanë të tërë...)

Nga shtatë e tetë  
na ndanë në grupe,  
nëpër makina  
na nisën tutje.

Thosha më vete  
ç'bëhet kështu?  
Ku po na shpien?  
S'dihet se ku!...

Ecën makina,  
m jegull dhe erë,  
ja ku na çuan  
në një minierë...

...Dhjetë vjet punë  
në galeri,  
s'tuhuen me gojë  
ç'kam parë me sy.



Na zbritnin thellë  
me një litar,  
iknim nga bota,  
zbritnim në varr.

Të paktën, thosha,  
kur je mbi tokë,  
shikon një lule,  
dëgjon një zog,

ndërsa këtu,  
në galeri,  
zhurmë dhë pluhur,  
qymyr i zi.

...Bluar nga lodhja  
bija në shtrat,  
mendja më ikte,  
vinte në fshat...

Sa mirë, o nënë,  
më thoshe ti:  
«Me bukë e hi  
e në shtëpi!»

## 2. Nga gruaja më 1938

...Ikën zogjtë dhe erdhën prapë,  
çelën lulet përséri,  
u rrit foshnja, kërkon babën,  
eja, eja ti!


Ka filluar të gugasë  
si pëllumbi mbi çati,  
ecën, bie, ngrihet prapë,  
eja, eja ti!...

## 3. Nga nëna më 1942

...As në ëndërr s'kisha parë  
erdhën trimat partizanë,  
për një lek e bënë aganë,  
derën e koçekut çanë,  
misriñ neve na e dhanë,  
se luftojnë për fuqaranë.

## 4. Nga familja më 1945

...Na mori të keqen beu,  
gjermani qafën e theu.  
Sot në fshat thuhet një këngë:



«Derdhëm gjak, po hodhëm rrënjet!»  
Hodhëm themele të reja,  
nëse je gjallë,  
eja!

### 5. Nga djali më 1946

Të shkruaj me dorën time,  
**kemi pasur plot gëzime,**  
mësova në shkollë me shokë  
dhe Pushteti na dha tokë.

Kemi plug e kemi qe,  
baba, eja, ç'bën atje?!

## Kënga e gjashtë

### KUR MORA LETRËN E DJALIT

«C'dritë më solli  
ajo letër!  
Pritmë, bir,  
do të vijë patjetër!

Ish një natë  
pis' e zezë,  
kur dola nga galeria,  
në dhomë,  
përmbi tryezë,  
gjej një zarf nga Shqipëria.

Përmbi pullë  
një yll i kuq  
dhe një shqipe madhështore,  
pranë tyre  
ishte shkruar  
«REPUBLIKA POPULLORE».

Pullë e re  
e shtetit tonë  
çau detet me furtunë,  
me një yll  
e një shqiponjë  
erdhi gjer atje tek unë.

### TRAKTA TË KURRUT E POKERIT

«...Hapa zafin,  
gjeta brenda  
letrën e shkrimin e djalit:  
Në qytet, qëndrova

«...Kemi plug  
e kemi qe,  
baba, eja, ç'bën atje?!»

Rreth e rrrotull  
nxinte nata,  
ç'dritë më solli ajo letër!  
Thirra  
me sa zë që pata:  
«Pritmë, bir, do të vij patjetër!»

\* \* \*

I bëra shkresat  
të gjitha,  
mblodha kursimet e mia,  
pastaj prita,  
prita, prita,  
për një javë nisej anija.

Zemra rrihte  
tak e tak!  
java m'u zgjat sa një shekull,  
krizë të fortë  
ndjeva atë natë,  
çdo gjë rrotull m'u bë mjegull.

U përmenda  
në spital,  
hiq, moj zemër, hiq e vuaj!  
I pagova  
gjithë kursimet,  
ngela prap' në dhé të huaj...

I sëmurë  
e pa fuqi,  
doja punë, doja bukë,

ñisa puñen  
përsëri,  
laja pjatat në një klub.

Njëzet vjet  
duart në ujë  
nga mëngjesi  
gjer në darkë,  
doja të mblidhja para,  
të mos vija varfanjak...

## Kënga e shtatë


### KËNGA QË SHKREPI SHKENDI

*S'na duhet para e huaj,  
punojmë në Atdhe,  
eja të shoç Shqipërinë,  
kush është si ne!*

Populli

Një natë, nga Radio-Tirana  
këngë e rë u transmetua,  
ishte «Kënga e kurbetit»,  
si e bërë tamam për mua:

*«Të përcollën nënë e nuse  
larg për në kurbet,  
nusja seç të tha mënjanë,  
kthehu, se të pres.  
Ike ditën e kiametit,  
oh, kjo ndarje e zezë!*



...Shkuan vite, ajo priti,  
të priti një jetë,  
u rrit djali, të bën letër,  
hajde, ç'bën atje!...»

.....  
Zemra ime e zhuritur  
nga kjo këngë shkrepi shkëndi...  
Erdhi dita që kam pritur,  
u nisa për Shqipëri.

Fluturon avioni lart,  
kalon male, fusha, dete,  
ika djale, kthehem plak,  
shita jetën në kurbete.

Vjen një zë nga megafoni:  
«Fluturojmë mbi Shqipëri»,  
hedh shikimin nga avioni,  
gjithë Atdheun kam në sy.

Malet me feste të bardhë,  
fushat me qilima shtruar,  
fshatrat e qytetet radhë.  
Shqipëri, qenke rinuar!

Oxhakët tündin shaminë  
si ata që heqin valle,  
malet mbi shpatulla mbajnë  
digat për hidrocentrale.

Shqipëri, o zemra ime,  
të lash' më dritë të kandilit,  
sot të gjej fribushur shkëlqime,  
ndritur nga trëzeti e yllit.

Emri i portor i Shqipërisë  
dhe i vlefshëm i popullit  
dhe që i cili është shteti i  
vlerave kulturore, historike.

Emri i portor i gjinisë së përmirë  
është emri i idhur i popullit  
i mesjetarëve, i shqiptarëve,  
za që nuk mundi

është emri i gjinisë së përmirë  
është emri i popullit i mesjetarëve  
i shqiptarëve, i shqiptarëve  
i mesjetarëve, i shqiptarëve

## Kënga e tetë

### N E F S H A T

Dolën bashkfshatarët,  
më pritën të porta,  
më që tharë zemra  
për dy fjalë të ngrohta...

Kur djali me nusen  
në fshat më piunë,  
i fërkova sytë  
mos isha, në gjumë.

Dolën bashkfshatarët,  
më pritën te porta,  
më që tharë zemra  
për dy fjalë të ngrohta...



I putha me mall  
shokët, gurët, tokën,  
bältën e vatánit  
që thë bërti kokën.

Hodha sytë nga fusha,  
ngrita sytë te mali,  
mbi pragun e portës  
më pikoi mälli.

O kurbet i shkretë,  
ç'emër të të vë?  
E lash' nënën plakë  
dhe s'e gjeta më.

Ç'emër të të vë,  
o kurbet i hidhur?  
E lash' nusen nuse,  
e gjeta të thinjur!

Djali, gjaku im,  
kaqë vjet s'më pa,  
e lash' çilimi,  
e gjeta baba...

Më thotë ime shoqe:  
«Plagës së kurbetit,  
vetëm kjo Parti  
ilaçin ia gjeti.

Erdhi tjetër kohë,  
erdhi tjetër jetë,  
sì jetojmë këtu,  
do ta shohësh vetë.

Djali agronom,  
nusja infermiere,  
mbesa dy-tri vjeçë  
cicërin në çerdhe

Ditët e kurbetit  
sa një shekull ishin,

Me mbesën e vogël  
u bëmë miq të mirë,  
vjen më puth në faqe,  
më heq pleqërinë.



Nis e kërcen vallë  
pët-pët si thëllëzë,  
pastaj thotë: «O xhish,  
të të them një këngë?»

Vesha një fustan  
dok nga kombinati,  
babai thotë: — Fustanin  
e ke nga Berati!

Kam një palë sandale  
të forta, të pastra,  
xhishja thotë: — Sandalet  
janë nga Xhirokastra!

Këto që kam veshur,  
a më kanë hije?  
Cë të xhitha tonat,  
prodhim Shqipëri!...»

E dëgjoj,  
qesh e kënaqem,  
i puth syçkat,  
i puth faqet.

Ajo fjalët

s'i thotë mirë,  
po në shpirt  
ka krenarini.  
Që në çerdhe  
krenaria,  
hajde ç'rrit  
sof Shqipëria!

Shqiptarit  
në përgjithësi  
në këtë vjet  
nëpër qytetin e  
shqiptarëve tani  
ç'rriti i tij po  
të dëshiron  
shqiptarët  
një qytet që  
nëpër qytetin e  
shqiptarëve tani  
ç'rriti i tij po

shqiptarit  
në përgjithësi  
në këtë vjet  
nëpër qytetin e

Bing! —  
Kënt shqit ës-  
të që — më që  
**Kënga e fundit** Çështje e fundit  
— edhe përfundim  
ashtu që  
— jetoj shqipë  
**LUM SI NE Ç'KEMI TE PORTA!**

I them djalit:  
— Dëgjo, bir:  
unë jam plak,  
po kam dëshirë,  
kam dëshirë  
që të shëtis  
anembanë  
Shqipërisë,  
dhe në fushë,  
edhe në mal,  
t'i shikoj  
veprat me radhë...

...E ku s'vajta,  
ku nuk shkova,  
që nga Fierza,

te Lukova.  
Pashë punëtorët  
të gëzuar,  
pashë fabrikat  
lartësuar,  
pashë malet  
zbukuruar.

Pashë brezaret  
e bregdetit,  
hodha sytë  
dhe përtej detit...  
U thash' shokëve  
të kurbetit:  
«E dëgjoni?  
Vjen një këngë,  
është këngë  
nga toka mëmë:  
lum si ne  
ç'kemi te porta,  
mrekullitë  
që s'i ka bota!»

1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871

1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871  
1870-1871

## PASQYRA E LËNDËS

1. BISEDË ME MBESËN .....	3
2. UDHA E KURBETIT .....	21

~~REVIEW OF THE SUBJECT~~

THEORY OF THE SUBJECT  
THEORY OF THE SUBJECT

Gjokutaj, T.

Bisedë me mbesën. Poemë. [Red. O.  
Grillo] T., «Naim Frashëri» 1983.

64 f me il (Bibliot. e pionierit)

(B. v.) : 891.983-93-1

(B. m.) dhe

GJ 91

---

Tirazhi 2000 kopje      Format 70x100/32      Stash 2204-82

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re — 1983